



16 PRILL 2015

BASHKËSIA/ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE: ÇFARË ËSHTË E (PA)MUNDUR NË KUADËR TË KORNIZËS LIGJORE TË KOSOVËS?

Autorët: Adrian Zeqiri & Pieter Troch

Autorët kontribues: Aleksandar Rapajić & Trim Kabashi

Edhe pse marrëveshja për themelimin e Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe (tutje: Asociacioni) lë shumë hapësirë për interpretime të ndryshme, diskutimet mbi kompetencat dhe strukturën e Asociacionit kanë lënë anash ato pak dispozita solide ligjore të parashikuara në Marrëveshjen e Brukselit të 19 prillit të vitit 2013 (tutje: Marrëveshja). Nenet 3 dhe 4 të Marrëveshjes në mënyrë të drejtpërdrejtë i referohen kornizës ligjore në kuadër të së cilës Asociacioni duhet të themelohet: “struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë si statuti ekzistues i Asociacionit të Komunave të Kosovës” (Neni 3); “komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre në pajtim me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjit të Kosovës” (Neni 4).

Në këtë analizë, që është e treta në një seri që synon të shtojë përmbajtje në diskutimet mbi Asociacionin, ne shqyrtojmë kornizën ligjore për bashkëpunim ndër-komunal të së cilës i referohet në Marrëveshje. Në veçanti, ne i shqyrtojmë në mënyrë të detajuar dispozitat ligjore të ndërlidhura me partneritetet ndërkomunale dhe me bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me Republikën e Serbisë, dhe gjithashtu i prezantojmë maksimumet ligjore për strukturën dhe kompetencat e Asociacionit në kuadër të legjislacionit të Kosovës.

1. PARIMET THEMELORE TË BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL

Komunat kanë të drejtë kushtetuese për bashkëpunim ndër-komunal dhe ndërkufitar.¹ Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet komunave është i rregulluar me Ligjin për Bashkëpunim Ndërkomunal, i cili zgjeron Kapitullin V të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Bashkëpunimi ndërkombëtar gjithashtu parashihej me *Propozimin Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës* (Plani i Ahtisaarit) dhe garantohet me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Parimet bazë të bashkëpunimit ndër-komunal janë që komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë dhe të krijojnë partneritete me komuna tjera të Kosovës, brenda fushës së tyre të kompetencave, për të realizuar funksione që janë në interes të përbashkët të tyre, si dhe të përmbushin qëllime dhe interesa të përbashkëta në fushën e shërbimeve publike komunale dhe të zhvillimit lokal.²

¹ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni 124.4.

² ‘*Ligji Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale*’ (20 shkurt 2008), Neni. 29.1; ‘*Ligji Nr. 04/L-010 për bashkëpunimin ndërkomunal*’ (21 korrik 2011), Neni 3.1.1.

Megjithatë, hierarkia midis komunave dhe trupit eventual ndër-komunal është e qartë. Siç përcaktohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, komunat janë njësi bazë të vetëqeverisjes lokale. Ato kanë të drejtë të themelojnë forma të bashkëpunimit ndërkomunal, por ato mbajnë të gjithë përgjegjësinë ligjore për aktet dhe veprimet që rezultojnë nga një bashkëpunim i tillë, dhe ligjshmëria e veprimeve të tyre në fushat e tyre të përgjegjësisë do të shqyrtohet nga autoritetet qendrore.³ Në të njëjtën frymë, Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale përcaktohen se “fuqitë e dhëna autoriteteve lokale normalisht do të jenë të plota dhe ekskluzive. Ato nuk mund të cenohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo regjional, përveç siç përcaktohet me ligj.”⁴ Kjo nënkupton se komunat nuk mund të transferojnë kompetencat ekzekutive të ndonjë autoritet super-komunal, dhe se përgjegjësia përfundimtare për vendimmarrje mbetet me organet komunale.

Roli i autoriteteve qendrore është i kufizuar në shqyrtimin e pajtueshmërisë ligjore të të gjitha vendimeve apo veprimeve të komunave me Kushtetutën dhe kornizën ligjore.⁵ Kjo vlen jo vetëm për vendimet e marra nga komunat, po edhe për vendimet komunale për aktivitetet e partneriteteve komunale.⁶ Nëse Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal vlerëson se një vendim apo akt i ndërmarrë nga një komunë është në kundërshtim me Kushtetutën apo ligjet, ai autoritet mund të kërkojë nga komuna që ta ri-shqyrtojë vendimin e marrë, duke deklaruar edhe arsyet për shkeljen e supozuar. Parimi këtu është që autoritetet qendrore nuk do ta shqyrtojnë punën e Asociacionit drejtpërdrejt, por nëpërmjet komunave pjesëmarrëse, duke qenë se komunat janë ligjërisht përgjegjëse për të gjitha aktet dhe veprimet e ndërmarra në kuadër të bashkëpunimit komunal kombëtar apo ndërkombëtar.

2. THEMELIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL

Procedura për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal fillon ose me iniciativë të ndërmarrë nga kryetari i komunës; 1/3 e asamblistëve komunalë; së paku 5% të qytetarëve të komunës me të drejtë vote; apo, nga Qeveria e Republikës së Kosovës.⁷ Në teori, pra, për themelimin e Asociacionit nuk është i nevojshëm ndonjë vendim i veçantë nga Qeveria e Kosovës: mund të iniciohet dhe zhvillohet nga komunat pjesëmarrëse, pas përcjelljes së procesit të përshkruar si më lartë. Iniciativa e kohëve të fundit për organizimin e takimeve të rregullta mes dhjetë kryetarëve serb të komunave dhe Qeverisë së Serbisë si një mjet për të shkuar përpara dhe “krijuar ngjarjet në terren dhe të mendohet për zyrtarizimin e tyre në një fazë të mëvonshme” mund të përdorë këtë hapësirë ligjore.⁸ Në takimin e parë të tillë të mbajtur më 18 mars 2015 në Graçanicë, përfaqësuesit politikë serbë prezantuan dhjetë kërkesa kyçe dhe pikë fokusi, duke përfshirë “veprim unitar politik, mbrojtja e të drejtave, dhe realizimi i interesave të popullit serb nëpërmjet formimit të një Asociacioni të fuqishëm të Komunave Serbe”, dhe se në një takim të ardhshëm drafti final i Statutit të Asociacionit do të shqyrtohej.⁹ Megjithatë, nuk ka gjasa të mëdha që një iniciativë e tillë e një-anshme për themelimin e Asociacionit mund të sjellë ndonjë rezultat ligjor, përveç që bën presion në Qeverinë e Kosovës dhe në BE-në. Për shkak të ndjeshmërisë së çështjes dhe përfshirjes së saj në negociatat mes qeverive të Kosovës dhe Serbisë, do të ishte e dëmshme nëse procesi për themelimin e Asociacionit do të iniciohej pa miratimin formal të Qeverisë së Kosovës.

³ ‘Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal’, Neni 4.3.

⁴ Këshilli i Evropës. *Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale* (Strasbourg, 1985), Neni. 4(4).

⁵ *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Neni. 124.7.

⁶ ‘Ligji për Vetëqeverisjen Lokale’, Neni 29, 76, 79, 82.

⁷ ‘Ligji për Bashkëpunimin Ndërkomunal’, Neni. 6.2, 6.3.

⁸ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=03&dd=11&nav_category=640&nav_id=967225.

Deklarata të tilla u dhanë edhe në tryezën e rrumbullakët “Decentralizimi dhe komuniteti serb në Kosovë”, e organizuar nga Forumi për Marrëdhënie Etnike në Graçanicë më 3 mars 2015.

⁹ http://kossev.info/strana/arhiva/razmatranje_nacrt_a_na_sledecem_zajednickom_sastanku_srpskih_opstina_na_kim_u/4212.

Në çdo rast, ashtu siç thuhet qartë në Ligjin për Bashkëpunim Ndërkomunal, iniciativa për bashkëpunim ndërkomunal duhet të mbështetet me të dhëna për qëllimin e bashkëpunimit, kompetencat që janë relevante për të, komunat e përfshira në këtë bashkëpunim, forma e bashkëpunimit, përfitimet e pritura, implikimet potenciale financiare që dalin nga ky bashkëpunim, si dhe çështje tjera të rëndësishme për themelimin e bashkëpunimit ndërkomunal.¹⁰

Duke u bazuar në këto detaje, kuvendet komunale përkatëse pastaj shqyrtojnë iniciativën për bashkëpunim ndërkomunal dhe marrin një vendim me shumicë votash në një seancë të hapur brenda 90 ditëve nga dita e paraqitjes së iniciativës. Në rast se Kuvendi Komunal miraton iniciativën, ai autorizon kryetarin e komunës që të përfaqësojë komunën gjatë procesit negociues për marrëveshjen përfundimtare për bashkëpunim ndërkomunal.¹¹

Kryetarët e komunave pjesëmarrëse pastaj do të negociojnë një marrëveshje formale për bashkëpunim ndërkomunal që përmban elementet si në vijim:

- Palët kontraktuese;
- Subjektin e kontratës, fushëveprimin dhe kohëzgjatjen;
- Të drejtat dhe obligimet e të gjitha palëve pjesëmarrëse në marrëveshje;
- Forma ligjore e bashkëpunimit dhe burimi i financimit dhe buxhetit;
- Kushtet për tërheqjen nga kontrata dhe për përfundimin e marrëveshjes;
- Procedura për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale.

Marrëveshja duhet të nënshkruhet nga kryetarët e të gjitha komunave pjesëmarrëse dhe të miratohet nga kuvendet komunale përkatëse. Marrëveshja hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë së saj nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.¹²

3. FUNKSIONIMI DHE KOMPETENCAT E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMUNAL: PARTNERITET APO ASOCIACION?

Një burim kryesor i keqkuptimeve në lidhje me Asociacionin buron nga paqartësia nëse Asociacioni do të ketë formën e bashkëpunimit ndërkomunal apo atë të asociacionit të komunave. Të dyja format janë të drejta të parapara sipas Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, Planit të Ahtisaarit, si dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, po dallimi mes dyjave më vonë ka humbur në Ligjin për Bashkëpunimin Ndërkomunal. Marrëveshja e Parë i referohet “Asociacionit/Bashkësisë” dhe “Bashkësisë/Asociacionit”, por nuk qartësohet se çfarë nënkuptohet me këtë terminologji, apo se a është e ndërlidhur me dallimin ligjor ndërmjet partneriteteve komunale dhe asociacioneve.¹³

Partneritetet komunale

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale i jep të drejtën autoriteteve lokale që të bashkëpunojnë dhe, në kuadër të kornizës ligjore, të formojnë konsorciume me autoritete tjera lokale në ushtrimin e kompetencave të tyre për kryerjen e detyrave me interes të përbashkët.¹⁴ Ligji për Vetëqeverisjen Lokale parasheh që komunat mund të ushtrorjnë përgjegjësi komunale në fushat e kompetencave të tyre vetanake dhe të zgjeruara përmes partneriteteve komunale.¹⁵ Përrjashtim bëhet për vendimet e mëposhtme, të cilat bien nën autoritetin e kuvendeve komunale dhe nuk mund të merren përsipër nga partneritetet ndërkomunale:

- Statutet apo rregulloret e punës dhe rregullore komunale;
- Miratimi i buxhetit dhe planeve të investimit;

¹⁰ ‘Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal’, Neni. 6.4.

¹¹ ‘Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal’, Neni. 6.

¹² ‘Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal’, Neni 4–8.

¹³ Balkans Policy Research Group. ‘Integrimi i serbëve në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit’, raport politikash i papublikuar (19 mars 2015), f. 31.

¹⁴ Këshilli i Evropës. *Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale* (Strasburg, 1985), Neni. 10.1.

¹⁵ ‘Ligji për vetëqeverisjen lokale’, Neni. 29.1.

- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimi i komiteteve siç kërkohet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale;
- Zgjedhja e Kryesuesit dhe Zv. Kryesuesit të Kuvendit Komunal;
- Niveli i tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimi dhe përdorimi i simboleve komunale, dekorimeve, dhe titujve të nderit;
- Emërtimi dhe riemërtimi i rrugëve, rrugicave, dhe vendeve tjera publike;
- Bërja e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda-komunale,
- Anëtarësimi në asociacione përfaqësuese të komunave.¹⁶

Partneritetet ndërkomunale mund të ndërmarrin të gjitha veprimet e mundshme për *zbatimin dhe ushtrimin* e bashkëpunimit funksional nëpërmjet:

- Themelimit të një *organi vendimmarrës* të përbërë nga përfaqësues të caktuar nga kuvendet komunale të komunave pjesëmarrëse;
- Angazhimit dhe shkarkimit të personelit administrativ dhe atij këshillëdhënës;
- Vendimeve për *financim* dhe nevoja tjera operative të partneritetit.¹⁷

Kjo dispozitë duket se nënkupton që partneritetet komunale mund të krijojnë organe vendimmarrëse që marrin vendime në fushën e veprimeve të dakorduara nga komunat pjesëmarrëse, duke përfshirë financimin e partneriteteve (edhe pse buxhetet dhe planet vjetore të punës janë vendime të cilat komunat nuk mund të ia delegojnë organeve tjera).

Asociacioni komunal

Komunat gjithashtu kanë të drejtë të formojnë një asociacion për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tyre të përbashkëta. Asociacione të tilla mund të i ofrojnë anëtarëve të tyre – komunave individuale – një numër shërbimesh, duke përfshirë trajnimet, ndërtimin e kapaciteteve, asistencë teknike, si dhe hulumtime në lidhje me kompetencat komunale dhe rekomandime të politikave.¹⁸

Në pajtim me këto dispozita, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është një organizatë jo-fitimprurëse si dhe person juridik që përfaqëson interesat e autoriteteve lokale. Objektiva e AKK-së janë nxitja e zbatimit të rregulloreve që burojnë nga Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë, dhe të organizojë dhe koordinojë aktivitetet e komunave në fushën e investimeve, zhvillimit ekonomik, përmirësimit të bazës ligjore, mbështetje biznesore, kulturë, arsim, shkencë, shëndetësi, mirëqenie dhe shërbime sociale, menaxhim të konflikteve, dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarë.¹⁹

Konkretisht, AKK:

- Inicion, organizon dhe promovon bashkëpunimin mes autoriteteve lokale;
- Propozon zgjidhje për problemet e përgjithshme me të cilat ballafaqohen autoritetet lokale në Kosovë;
- Jep mendime dhe sugjerime mbi propozimet për ligje dhe akte nënligjore që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale
- Ofron mbështetje ligjore dhe organizative për komunat;
- Përfaqëson interesat e përgjithshme të autoriteteve lokale brenda organizatave të Kosovës dhe atyre ndërkombëtare;
- Organizon dhe bashkërendon trajnime profesionale për autoritetet politike komunale dhe për nëpunësit civilë;

¹⁶ 'Ligji për vetëqeverisjen lokale', Neni 29.1, 40; 'Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal', Neni. 4.2.

¹⁷ 'Ligji për vetëqeverisjen lokale', Neni. 29.3. Kjo është marrë fjalë për fjalë nga Plani i Ahtisaarit. [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës](#) (26 mars 2007), Shtojca III, Neni 9.1.2.

¹⁸ 'Ligji për Vetëqeverisjen Lokale', Neni 31–32; [Propozimi Gjithëpërfshirës për Kosovën](#), Aneksi III, Neni. 9.2. Kjo është gjithashtu në pajtim me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, që i garanton autoriteteve lokale të drejtën për pjesëmarrje në asociacione për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta. Këshilli i Evropës. [Karta](#), Neni. 10.2.

¹⁹ Asociacioni i komunave të Kosovës, [Statuti i Asociacionit të Komunave të Kosovës](#) (Prishtinë, 2010), Neni 2.

- Harton dhe shpërndan informata dhe publikime për anëtarët e saj;
- Krijon fonde, hap trupa përfaqësimi dhe institucione publike.²⁰

Me përjashtim të pikës së fundit, AKK ka një rol të qartë mbështetës, avokues, dhe lehtësues që korrespondon me shumë me një asociacion komunal se sa me një partneritet komunal. Reduktimi i rolit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe në një rol thjesht këshillues dhe mbështetës të ngjashëm me atë të Asociacionit të komunave të Kosovës duket joproduktiv dhe kufizues. Kjo natyrisht që nuk përputhet me pritjet e komunitetit serb të Kosovës, nuk shter mundësitë ligjore për bashkëpunim ndërkomunal, dhe duket i tepërt krahas Asociacionit ekzistues të komunave të Kosovës. Referenca në strukturën e AKK-së si bazë për strukturën e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Marrëveshjen e Parë (Neni 4) i referohet më tepër *strukturës organizative* të AKK-së sesa *kompetencave* të tij, për shkak se Marrëveshja i referohet strukturave të AKK-së (Presidentit, Kuvendit, dhe Këshillit). Në këtë linjë arsyetimi, termi “Asociacion” (“Association” në gjuhën angleze), që ka qenë i kodifikuar në gjuhën angleze dhe shqipe për të paraqitur Asociacionin/Bashkësinë e komunave me shumicë serbe, është i papërshtatshëm, meqë duket se kufizon rolin e Asociacionit vetëm me rolin mbështetës, avokues, dhe lehtësues të asociacioneve komunale të përmendura në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe shkakton konfuzion me Asociacionin ekzistues të komunave të Kosovës.²¹

Llojet e bashkëpunimit ndër-komunal

Ligji për bashkëpunim ndërkomunal elaboron mbi strukturat e përbashkëta nëpërmjet të cilave mund të realizohet bashkëpunimi ndërkomunal:

- Trupat e *përbashkët punues dhe komisionet* për shqyrtimin e çështjeve të caktuara të përcaktuara nën kompetencat e komunës.²²
- Trupat e *përbashkët administrativë* për kryerjen e kompetencave të caktuara komunale dhe kryerjen e punëve profesionale dhe administrative brenda kompetencave të përcaktuara me marrëveshje. Komunitat pjesëmarrëse caktojnë nëpunësit civilë për të punuar në trupin e përbashkët administrativ. Megjithatë, këto trupa nuk janë persona juridikë dhe përgjegjësitë përfundimtare i mbeten komunave.²³ Me fjalë të tjera, Asociacioni nuk mund të themelojë departamente që do të zëvendësojnë autoritetin e kuvendeve komunale/drejtorive komunale.
- Ndërmarrjet e *përbashkëta publike* për kryerjen e shërbimeve publike në nivelin lokal, në përputhje me kushtet dhe procedurat e vendosura me Ligjin për ndërmarrjet lokale.²⁴
- Institucionet e *përbashkëta publike* për kryerjen e aktiviteteve të caktuara të interesit publik dhe me rëndësi në fushat e arsimit, shëndetësisë, kulturës, mbrojtjes sociale, dhe fusha të tjera. Kryetarët e të gjitha komunave pjesëmarrëse nënshkruajnë marrëveshje që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet reciproke në lidhje me institucionet publike. Vendimi për krijimin e një institucioni të tillë publik duhet të miratohet me shumicën e votave në kuvendet komunale, bazuar në verifikimin e burimeve të siguruara nga themeluesit, burimet e përhershme të financimit, të drejtat dhe detyrimet e themeluesit, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të institucionit dhe të themeluesve, kohëzgjatja e veprimeve, dhe në strukturën e organizimit dhe të menaxhimit të organizatës.²⁵

²⁰ Asociacioni i komunave të Kosovës, [Statuti](#), Neni 3.

²¹ Ekuivalenti serb për “bashkësi” (“zajednica”) është tashmë në përdorim të zakonshëm në vend të ekuivalentit për “asociacion” (“asocijacija”). Grupi i krizave ndërkombëtare dhe Grupi për hulumtimin e politikave të Ballkanit preferojnë të përdorin termin komuniteti në vend të shoqata/asociacioni, për arsye të efikasitetit dhe për shmangur konfuzionin me Asociacionin ekzistues të komunave të Kosovës. Balkans Policy Research Group, ‘Integrimi i serbëve në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit’, raport i pabotuar politik (19 mars 2015), faqe 28.

²² [‘Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal’](#), Neni 10.

²³ [‘Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal’](#), Neni 11.

²⁴ [‘Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal’](#), Neni 12.

²⁵ [‘Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal’](#), Neni 13.

e) Partneritete të përbashkëta publiko-private për kryerjen e shërbimeve publike në nivelin lokal dhe sigurimin e infrastrukturës publike, në përputhje me legjislacionin për partneritete publike-private.²⁶

f) Së fundi, një komunë mund t'i japë mandat, në bazë të marrëveshjes, një komune tjetër për të ushtruar kompetenca të caktuara, ndërsa mbetet përgjegjëse për të gjitha veprimet dhe aktet e ndërmarra nga komuna e mandatuar.²⁷

Në këtë mënyrë, Ligji për bashkëpunim ndërkomunal ofron mundësi të shumta për ushtrimin e përbashkët të kompetencave nga ana e komunave në fushën e shërbimeve publike në nivel komunal. Megjithatë, Ligji për bashkëpunim ndërkomunal nuk bën dallimin midis 'partneritetit' dhe 'asociacionit', dhe nuk shtjellon për më tepër mbi organin vendimmarrës, që është përmendur si një mënyrë e realizimit të partneriteteve komunale në Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Planin e Ahtisaarit. Kështu, zvogëlon në mënyrë të konsiderueshme kompetencat vendimmarrëse të çdo forme të bashkëpunimit ndërkomunal. Duke marrë parasysh faktin se ky është pikërisht roli dhe kompetenca që pala serbe parashikon për Asociacionin, paqartësitë juridike mund të kërkojnë sqarime dhe përshtatje. Megjithatë, në frymën e Kushtetutës dhe legjislacionit mbi vetëqeverisjen lokale të Kosovës dhe me Kartën evropiane të vetëqeverisjes lokale, komuna mbetet njësisia kryesore e vetëqeverisjes lokale dhe mban të gjitha përgjegjësitë ligjore për aktet, veprimet dhe vendimet eventuale të marra nga Asociacioni.

4. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ASOCIACIONIT

Siç u argumentua më lart, referenca për Asociacionin e Komunave të Kosovës në Marrëveshjen e Parë i referohet strukturës organizative të AKK-së, dhe jo kompetencave apo aktiviteteve të tij. AKK-ja përbëhet nga tri organe organizative. Kuvendi është organi më i lartë i AKK-së, dhe përbëhet nga përfaqësues të kuvendeve komunale pjesëmarrëse.²⁸ Kuvendet komunale delegojnë një përfaqësues për çdo dhjetë anëtarë të kuvendit në kuvendin e AKK-së, në proporcion me votat që secila parti ka fituar në zgjedhjet komunale. Kuvendi mbledhet të paktën një herë në vit dhe i merr vendimet për statutin, procedurat dhe rregulloret e punës, planet e punës vjetore dhe buxhetin, dhe për strategjinë e AKK-së. Për më tepër, Kuvendi zgjedh një Kryetar dhe një Zëvendës Kryetar të AKK-së, dhe miraton simbolet e AKK-së. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë, ndërsa ndryshimet në statut kërkojnë miratimin e 2/3 të anëtarëve të Kuvendit.²⁹

Këshilli i Kryetarëve të komunave administrojnë AKK-në dhe mbledhet çdo tre-muaj. Këshilli përbëhet nga kryetarët e të gjitha komunave dhe anëtarët e Bordit (shih më poshtë). Me rekomandim të Bordit, Këshilli analizon dhe formulon vendime për aktet dhe projekt-vendimet që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale, si dhe çështjet e propozuara nga Bordi dhe nga anëtarët e Këshillit.³⁰

Bordi i AKK-së përbëhet nga shtatë anëtarë të zgjedhur të Kuvendit të AKK-së: kryetari, nënkryetari, dhe pesë anëtarë të Kuvendit. Tre anëtarë të bordit (duke përfshirë edhe Kryetarin) përfaqësojnë partinë që ka fituar në shumicën e komunave në zgjedhjet e fundit lokale, dy anëtarë (duke përfshirë nënkryetarin) përfaqësojnë partinë e dytë, një anëtar nga partia e tretë në zgjedhjet e fundit lokale, dhe një anëtar nga radhët e partive të komunitetit serb. Bordi mbledhet një herë në muaj dhe diskuton problemet e ngritura nga Kuvendi ose Këshilli, dhe nxjerr vendime dhe bën propozime për përmirësimin e vetëqeverisjes lokale. Përveç kësaj, Bordi

²⁶ 'Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal', Neni 9.

²⁷ 'Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal', Art. 14.

²⁸ Ky kuvend në mënyrë të strukturuar korrespondon me organin vendimmarrës të përmendur në Ligjin për vetëqeverisjen lokale.

²⁹ Asociacioni i komunave të Kosovës, [Statuti](#) (Prishtinë, 2010), Neni 4(1–14).

³⁰ Asociacioni i komunave të Kosovës, [Statuti](#) (Prishtinë, 2010), Neni 4(15–17).

konfirmon marrëveshjet e arritura nga AKK-i, definojnë dhe përcaktojnë detyrat dhe strukturat administrative, monitorojnë aktivitetet financiare të AKK-së, dhe shqyrtojnë planin e aktiviteteve dhe raportet administrative.³¹

Administrimi i përditshëm dhe menaxhimi bëhen nga Kryetari i AKK-së dhe organet e tij administrative. Kryetari i AKK-së nënshkruan marrëveshje me autorizim të Bordit, organizon punën e organeve menaxhues të AKK-së, dhe përfaqëson AKK-në.³² Aktivitete administrative të AKK-së organizohen nga administrata e AKK-së dhe organet e saj drejtuese, nën udhëheqjen e Drejtorit të Administratës. Administrata punon në bazë të ligjeve dhe rregulloreve të miratuara nga Kuvendi, Këshilli dhe Bordi.³³

Kjo strukturë organizative dhe ndarja e detyrave mundet lehtësisht të aplikohet për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Megjithatë, kompetencat e secilit prej trupave do të duhet të ripërcaktohen në përputhje me kompetencat që Asociacioni do të ketë në bazë të marrëveshjes së partneritetit ndërmjet komunave, që do të jetë më shumë në përputhje me ato të një partneriteti komunal sesa të AKK-së.

5. LIDHJET ME REPUBLIKËN E SERBISË

Asociacioni është parë nga përfaqësuesit politikë serbë dhe nga shumë pjesëtarë të komunitetit serb, si një mjet për të forcuar dhe mbështetur lidhjet në mes të popullatës serbe të Kosovës dhe Republikës së Serbisë, pa (shumë) ndërhyrje nga Prishtina. Edhe pse bie ndesh me të kuptuarit tradicional të një shteti sovran, Asociacioni në të vërtetë do të mund të jetë një mekanizëm i dobishëm për përkrahje të qëndrueshme dhe transparente për komunitetin serb të Kosovës nga ana e Republikës së Serbisë. Kjo është krejtësisht në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, e cila ofron mundësi për bashkëpunim dhe mbështetje të Republikës së Serbisë, me kusht që të mos anashkalohen autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës dhe që roli i Republikës së Serbisë të mbetet i kufizuar në ndihmë financiare dhe teknike në zbatimin e kompetencave komunale. Në të vërtetë, Ligji për vetëqeverisje lokale u mundëson komunave të bashkëpunojnë, brenda fushave të kompetencave të tyre, me komunat dhe institucionet, përfshirë agjencitë qeveritare, në Republikën e Serbisë. Një bashkëpunim i tillë mund të marrë formën e ofrimit të asistencës financiare dhe teknike, përfshirë personelin dhe pajisjet e specializuara, në zbatimin e kompetencave.³⁴

Më tej, partneritetet komunale kanë të drejtë për marrëdhënie të drejtpërdrejta me institucionet në Republikën e Serbisë, por vetëm në masën e nevojshme për zbatimin praktik të aktiviteteve të partneritetit.³⁵ Megjithatë, komunat paraprakisht do të njoftojnë Ministrinë e Administrimit të pushtetit lokal për çfarëdo qëllimi për t'u angazhuar në bashkëpunim ndërkufitar, duke përfshirë një marrëveshje bashkëpunimi që do të ofronte informacion për objektivat e bashkëpunimit, praktikat dhe modalitetet për ofrimin e personelit dhe pajisjeve, nivelin e financimit, dhe mekanizmat e financimit. Nëse Ministria konsideron marrëveshjen në shkëlqim të ligjit, ajo mund të propozojë amendamente apo të suspendojë bashkëpunimin e synuar.³⁶

Ligji për bashkëpunim ndërkomunal më tej përcakton që brenda bashkëpunimit ndërkombëtar komunal "komunat nuk mund të tërhiqen nga kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj, për t'i deleguar një komune ose një autoriteti të huaj publik kryerjen e kompetencave vetanake dhe

³¹ Asociacioni i komunave të Kosovës, [Statuti](#) (Prishtinë, 2010), Neni 4(18–21).

³² Asociacioni i komunave të Kosovës, [Statuti](#) (Prishtinë, 2010), Neni 4(22–23).

³³ Asociacioni i komunave të Kosovës, [Statuti](#) (Prishtinë, 2010), Neni 4(.

³⁴ ['Ligji për vetëqeverisjen lokale'](#), Neni 30.2 Mbështetja financiare nga Republika e Serbisë ndaj Asociacionit do të trajtohet në raportin në vijim.

³⁵ ['Ligji për vetëqeverisjen lokale'](#), Neni 30.7

³⁶ ['Ligji për vetëqeverisjen lokale'](#), Nenet 30.3, 30.4, 30.5,

për të lejuar një komunë ose autoritet publik të huaj të ushtrojë ndonjë fuqi ekzekutive, administrative, apo legjislative në territorin e Republikës së Kosovës”.³⁷ Në parim, kjo nënkupton që përveç mbështetjes financiare, e cila nuk është e trajtuar në këtë analizë, Asociacioni mund të kërkojë mbështetje teknike dhe ndihmë nga Republika e Serbisë në zbatimin e aktiviteteve praktike. Megjithatë, Republika e Serbisë nuk mund të ushtrojë asnjë pushtet ekzekutiv, administrativ apo legjislativ nëpërmjet Asociacionit.

6. PËRFUNDIM

E drejta e bashkëpunimit ndërkomunal është e rrënjosur fort në legjislacionin e Kosovës dhe në Kartën evropiane mbi vetëqeverisjen lokale. Kuadri ligjor u mundëson komunave të krijojnë partneritete komunale në iniciativë të tyre me qëllim të zbatimit dhe të ushtrimit të bashkëpunimit funksional të kompetencave komunale me interes të përbashkët. Partneritete të tilla komunale mund të marrin forma të ndryshme, nga një organ vendimmarrës, i përbërë nga përfaqësues të kuvendeve komunale të komunave pjesëmarrëse, deri në trupa të përbashkëta administrative, institucione publike, dhe ndërmarrje publike. Për më tepër, këto partneritete kanë të drejtë të vendosin marrëdhënie të drejtpërdrejta me institucionet e Republikës së Serbisë për zbatimin e aktiviteteve praktike të partneritetit. Ligji gjithashtu parashikon asociacione komunale me një rol përfaqësues dhe avokues.

Marrëveshja për Asociacionin duket të sjellë së bashku rolin e kufizuar përfaqësues dhe avokues të një asociacioni të komunave me struktura për partneritet ndërkomunal për ushtrimin e përbashkët të kompetencave. Gjithashtu, edhe pse nuk ka asnjë referencë të drejtpërdrejtë në Marrëveshje, Asociacioni mund të jetë një mekanizëm i koordinimit për bashkëpunim të drejtpërdrejtë ndërmjet komunave dhe Republikës së Serbisë, siç parashihet me ligjin e Kosovës.

Megjithatë, komunat mbesin njësi themelore të qeverisjes lokale. Ato janë persona juridikë dhe janë ligjërisht përgjegjëse për kompetencat që ato kanë. Përveç nëse tërë korniza kushtetuese dhe ligjore ndryshohet, asnjë organ supra-komunal nuk mund të gëzojë kompetenca ligjore që aktualisht janë brenda kompetencave të Komunës. Për më tepër, struktura të tilla supra-komunale me status ligjor do të vuajnë nga një deficit demokratik, duke qenë organe që nuk janë zgjedhur.

Për më shumë informata ju lutem na kontaktoni në + 381 (0) 38 224 473 ose përmes postës elektronike në info@ecmikosovo.org

³⁷ ‘Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal’, Neni 18.3

Raporte dhe analiza të tjera politike:

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: një klub ekskluziv i bazuar në përkatësinë ethnike?](#)
31 mars, 2015

[Komunitetet pakicë jo-serbe të neglizhuar në marrëveshjet teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë](#)
10 mars, 2015

[Deklarata e diskutueshme e ministrit Murati dhe reagimet që pasuan](#)
5 mars, 2015

[Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe mos-zbatim](#)
22 shkurt, 2015

[Një sistem i unifikuar juridik dhe gjyqësor në Kosovë?](#)
15 shkurt, 2015

[Çfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)
8 shkurt, 2015

[Thirrje për Arsye dhe Veprim pas protestave në Prishtinë](#)
25 janar, 2015

[Farkimi i një ambienti të punës në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)
19 janar, 2015

[ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes në Kishën Ortodokse Serbe në Gjakovë](#)
7 janar, 2015

[Formimi i Qeverisë së re të Kosovës, Përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe Sfidat që dalin përpara](#)
10 dhjetor, 2014

[Një vështrim mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë](#)
4 nëntor, 2014

[Komunitetet pakicë dëshirojnë të shohin fundin e ngërçit politik](#)
23 tetor, 2014

[Partitë politike të minoriteteve në mjedisin politik në ndryshim e sipër në Kosovë](#)
31 korrik, 2014

[ECMI Kosova bën thirrje për qetësi pas përshkallëzimit të tensioneve ethnike pas ndeshjes kualifikuese në futboll midis kombëtareve të Serbisë dhe Shqipërisë](#)
15 tetor, 2014

[Ndërlidhja e ndarjes: Krijimi i një Bordi të Përbashkët për qytetin e Mitrovicë](#)
27 qershor, 2014

[Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një Shikim i Çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit](#)
2 qershor, 2014

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.